



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 24.2.2025

Nr: 144

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “NISMA THURJE”, ME  
KRYETAR Z. ENDRIT SHABANI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR,  
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me datë 18.2.2025, me:

**KËRKUES:** Partia politike “Nisma Thurje”, me kryetar z. Endrit Shabani

**OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike “Nisma Thurje” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

**BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “Nisma Thurje”, nëpërmjet Kryetarit, z. Endrit Shabani, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 24.2.2025 Nr: 144  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Nisma Thurje” me Kryetar z. Endrit Shabani, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, datë 18.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Nisma Thurje”, me iniciale “Nisma”, me Kryetar z. Endrit Shabani, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Nisma Thurje” me shkronja nistore “Nisma”, me adresë: Rruga "Jan Kukuzeli", nr.52, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Endrit Shabani, me adresë: Rruga "Hoxha Tahsin", Tiranë.
- c) Financieri i partisë është z. Panajot Soko, me adresë: Rruga “Jordan Misja” ,Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Zj. Brunilda Dhrami, me adresë: Rruga “Sulo Resuli”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Nisma Thurje”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Nisma Thurje”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”.

## V E N D O S:

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Nisma Thurje”, me kryetar Z. Endrit Shabani, me shkronjat nistore “Nisma”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**